



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:017457

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05738537

Ac.nr.2632/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A. dhe T.Xh., që të dy nga Vushtrria, të cilit i përfaqësojnë M. dhe B.S., avokat nga Prishtina, kundër të paditurave K.S. “S.” dhe K.S. “I.”, që të dyja me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësve, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.591/2020 të datës 05.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësve A. dhe T.Xh., që të dy nga Vushtrria, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.591/2020, i datës 05.01.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.591/2020 të datës 05.01.2021, në pikën një të dispozitivit e ka refuzuar të pa bazuar kërkesëpadia e paditësve A. dhe T.Xh., nga Vushtrria, me të cilën kanë kërkuar që të prishen Ujditë jashtëgjyqësore të lidhura në mes të paditësve dhe të paditurave, Ujdia nr.2336/06, e dt. 18.02.2010 e lidhur në mes të K.S “D.” dhe paditëses T.Xh., Ujdia 2462a/09, dt. 19.03.2010, e lidhur në mes të K.S “S.” dhe paditëses T.Xh. si dhe Ujdia nr. 2462B/09, dt. 01.04.2010, e lidhur në mes të K.S “S.” dhe paditësit A.Xh., kërkesëpadia e paditëses T.Xh. me të cilën ka kërkuar që të detyrohen të paditurat K.S. “S.” dhe “I., me seli në Prishtinë, që në mënyrë solidare, në bazë të përgjegjësisë për dëmin e pësuar, pjesën e mbetur të pa paguar të kompensimit të dëmit material dhe jo material për aksidentin e datës 11.06.2009, ti kompensojnë, shumën e përgjithshme prej 22,900.00€, (njëzetedymijë e

nëntëqind euro) dhe atë: 591/2020 të datës 05.01.2021 në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 4,000.00€, në emër të frikës shumë prej 3,000.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshme jetësor shumë prej 15,000.00€ - - në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 300.00€, në emër të ndihmës nga personi i tretë shumë prej 300.00€, në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumë prej 300.00€, si dhe kërkesëpadia e paditësit A.Xh. me të cilën ka kërkuar që të detyrohen e paditura K.S. "S." për dëmin e pësuar, pjesën e mbetur të pa paguar të kompensimit të dëmit material dhe jo material, për 50% të përgjegjësisë ti kompensojë, shumë e përgjithshme prej 19,400.00€, (nëntëdhjetëmijë e katërqind euro) dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 3,500.00€, në emër të frikës shumë prej 3,000.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshme jetësor shumë prej 12,000.00€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 300.00€, në emër të ndihmës nga personi i tretë shumë prej 300.00€, si dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumë prej 300.00€, të gjitha këto me kamatën prej 8%, e cila fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë, deri në pagesën definitive, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm. Në pikën dy të dispozitivit secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësve, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, që ankesën e paditësve ta aprovoj si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj dhe pastaj ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, me padinë e parashtruar në gjykatën e shkallës së parë, kanë kërkuar që të detyrohen të paditurat: K.S "S." dhe K.S "I.", për kompensimin e dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 11.06.2009, fillimisht të prishen Ujdit jashtëgjyqësore të lidhura në mes të paditësve dhe të paditurave, sepse me këtë kompensim janë dëmtuar paditësit sepse kanë qenë jo reale, andaj kanë kërkuar që të detyrohen të paditurat që në mënyrë solidare t'ia paguaj paditësve shumat e kërkuara si në precizim të kërkesëpadisë. Të paditurat e kanë kontestuar kërkesëpadinë e paditësve duke theksuar se në procedurë jashtëgjyqësore paditësit janë kompensuar sipas ujdive të lidhura, të cilat kanë qenë shuma reale, ndërsa paditësit nuk janë dëmtuar, sepse paditësit nuk kanë rënë në lajthim me ofertat e pranuar, nën ndikim, kërcënim apo mashtrim.

Duke vepruar sipas padisë, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka vendosur për refuzimin e kërkesëpadisë, pas administrimit dhe shqyrtimit të provave: raportin policor i aksidentit nr.2009-BR-325, dt. 11.06.2009, raportin e QKUK-së nr. 17611, dt. 11.06.2009, për paditësin A.Xh., Raportin e QKUK-së nr. 17653, dt. 11.06.2009, për paditësen T.Xh., Ujdia jashtëgjyqësore D.nr.2336/009, dt. 18.02.2010, Ujdia jashtëgjyqësore nr. 2462a/09, dt. 19.03.2010, Ujdia jashtëgjyqësore nr. 2462b/09, dt. 01.04.2010, ekspertiza e komunikacioni

dt. 10.08.2009 si dhe ekspertizën mjekësore dt. 21.06.2016. Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të tyre ka vendosur që të refuzohet kërkesëpadia e paditësve, duke u bazuar në dispozitat e nenit 1089, 1090, 1091 dhe 1092 të LMD-së, ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as me shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i paqartë dhe kundërthënës me arsyetimin dhe provat e administruara, faktet vendimtare janë të paqarta dhe kontradiktore. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Aktgjykimi përmban edhe referencën sa i përket të drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse në mes palëve nuk ka qenë kontestuese se paditësit kanë lidhur ujdite jashtëgjyqësore dhe të njëjtit janë kompensuar sipas atyre ujdive për dëmin që iu është shkaktuar paditësve në aksidentin e komunikacionit të datës 11.06.2009. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve për anulimin e marrëveshjeve jashtëgjyqësore, për faktin se ujdite anulimi i të cilave kërkohet janë lidhur pranë kompanive të sigurimit dhe gjykata nuk ka për obligim ligjor që të anuloj marrëveshjet e lidhura në mes të palëve në procedurë jashtëgjyqësore. Po ashtu sa i përket pretendimit të paditësve se me ujdite e këtilla të lidhura janë dëmtuar sepse kanë qenë jo reale, pasi që paditësit kanë pësuar lëndime të rënda trupore dhe për këtë janë vënë në lajthim dhe janë dëmtuar përtej gjysmës, është pretendim i paqëndrueshëm sepse me dispozitën e nenit 1094 të LMD-së, është e përcaktuar se: *“Për shkak të dëmtimit përtej masës nuk mund të kërkohet anulimi i pajtimit”*. Në mes tjerash në pajtimi jashtëgjyqësor - Ujdia nr. 2462B/09, dt. 01.04.2010, e lidhur në mes të paditësit A.Xh. dhe të paditurës së parë K.S “S.”, si dhe Ujdia nr. 2462a/09, dt. 19.03.2010, e lidhur në mes të paditëses T.Xh. dhe të paditurës së parë K.S “S.”, në piken 2 të tyre, është thënë: *“Kjo Ujdi jashtëgjyqësore është lidhur me vullnetin e palëve, pa kërcënim, kanosje apo mashtrim, në mungesë të lajthimit real dhe juridik, kështu që e njëjta nuk përmban asnjë element të nulitetit absolut apo relativ, kështu që palët e ujdise e konsiderojnë si pune të vlefshme juridike dhe pa*

vërejtje e nënshkruajnë si të tillë". Po ashtu në pajtimin jashtëgjyqësor - Ujdinë nr. 2336/06, dt. 18.02.2010 të lidhur me paditësen T.Xh. dhe të paditurës se Dytë K.S. "D.", në piken 3, është theksuar: *"me këtë rast jam plotësisht i kënaqur dhe se janë përmbushur të gjitha kërkesat tona me zhdëmtimin e demit me rastin e aksidentit në fjale dhe nuk kemi asnjë pretendim në e ardhmen ndaj K.S. "D.", e as ndaj shkaktarit të aksidentit, si pale e trete lidhur me këtë rast"*.

Andaj, nuk qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarit të paditësve se përfaqësuesi i paditësve në procedurën e lidhjes së ujdive jashtë gjyqësore me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve me të paditurat nuk ka pasur njohurit e duhura adekuate të çështjeve ligjore dhe nuk gjendet në listën e OAK-së, sepse përfaqësuesi i paditësve ka pasur autorizimin e rregullt nga paditësit, e duke u mbështet në dispozitën e nenit 86 paragrafi 1 të LPK- është me të cilën është përcaktuar se: *"Përfaqësues me prokurë i palës mund të jetë çdo person që ka zotësi të plotë për të vepruar"*, ndaj në rastin konkret sipas kësaj dispozite ligjore përfaqësuesi me prokurë i paditësve i ka përfaqësuar ata në mënyrë të rregullt në procedurën jashtëgjyqësore.

Gjykata e Apelit e refuzoj si të pabazuar pretendimin ankimor të autorizuarit të paditësve, se paditësit kanë qenë të detyruar që të nënshkruajnë marrëveshjet jashtëgjyqësore me të paditurat dhe se kanë qenë në pozitë të pavolitshme dhe janë detyruar të lidhin ujdite jashtëgjyqësore, sepse me asnjë provë nuk e kanë provuar se kanë pasur një detyrim të tillë, se ka pasur të meta në deklarimin e vullnetit të tyre për të lidhur ujdite jashtëgjyqësore, andaj bazuar në dispozitën e nenit 319 paragrafi 1 të LPK-së me të cilën është e përcaktuar se: *"Secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta"*, del se pretendimet e tilla janë të pa mbështetura në prova, ndaj edhe u refuzuan si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes, shqyrtoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqës, por të njëjtat nuk patën ndikim relevant në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2632/2021, me datë 22.05.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.